

## PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit).*

#### **OBJEKTI I PROCEDURES:**

"Uniforma"

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

18110000-3-Veshje profesionale

18800000-7-Kepucë

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

39,815,938 Tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nenteqind e tridhjetë e tete leke pa TVSH e ndare ne dy lote

Loti 1 këpuce me qafa me vlerë 7,009,200 Shtatë milion e nëntë mijë e dyqind leke pa TVSH

Loti 2 veshje me vlerë 32,806,738 tridhjetë e dy milion e tetëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tete leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; nenit 2 pika 2/c, 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria "ILLYRIAN GUARD" Sh.A., ka hartuar Procesverbalin për Argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve teknike dhe Krieteve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-se, nenit 26 të

VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të LPP-se, nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

*Autoriteti Kontraktor njësia e prokurimit e shikon të arsyeshme vendosjen e shënimit të mësipërm për të synuar sigurimin e ofertimit nga OE të pergjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe vepronë sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi, te vendit ku ushtrojnë aktivitetin.*

## **2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, OE duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se: Vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e përlllogaritur të kontratës objekt prokurimi në këtë procedurë, si dhe në nenin 77 pika 3 e LPP, si dhe nenin 43/2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

*Duke marrë në konsiderate sasinë dhe cilesinë e mallrave objekt prokurimi, kerkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik/ financiar edhe për këtë qëllim. Vlera e xhiros se kerkuar është vendosur duke pasur ne konsiderate objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejne AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomike, të cilet, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e kopjes se deklaratave të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 29.*

2. OE duhet të paraqesin kopje të certifikuara të Bilanceve vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2019,2020 dhe 2021, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Per Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e tre viteve të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të LPP, si dhe nenin 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është i nevojshëm që OE të paraqesë dhe vërtetojë vijueshmërinë e aktivitetit të tij dhe zbatimin e ligjit, si dhe stabilitetin financiar të OE që do të kryejë zbatimin e kësaj procedure furnizimi artikujsh për AK, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet te vërtetojne se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### **2.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Për Lotin 1

1. Për të provuar përvojat e mëparshme, OE duhet të paraqesin dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, për një vlerë totale jo me pak se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar nga nje Ent publik, OE duhet të paraqesë:

Vërtetimin e lëshuar nga Enti publik për permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates, ose, fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara. Paraqitja e njerit prej dokumentave te sipercituara do te konsiderohet i mjaftueshem.

b) Kur furnizimet e meparshme, te ngjashme, janë realizuar me sektorin privat, OE duhet të paraqesë si deshmi vetem Fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Për Lotin 2

1. Për të provuar përvojat e mëparshme, OE duhet të paraqesin dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, për një vlerë totale jo me pak se 39% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar nga nje Ent publik, OE duhet të paraqesë:

Vërtetimin e lëshuar nga Enti publik për permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates, ose, fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara. Paraqitja e njerit prej dokumentave te sipercituara do te konsiderohet i mjaftueshem.

b) Kur furnizimet e meparshme, te ngjashme, janë realizuar me sektorin privat, OE duhet të paraqesë si deshmi vetem Fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Faturat të jenë të deklaruar në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 41, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 55, pika 4, germa b dhe nenin 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". *Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 39% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, e cila është brenda vleres kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e OE ofertues në ofrimin e mallrave artikuljve që janë objekt prokurimi, për realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa qe do te ndikonin ne ecurinë e punës së AK.*

2. OE ofertues duhet te deklarojnë nese jane ose jo prodhues te artikujve objekt prokurimi dhe nese OE ofertues nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 84 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik". AK duke lejuar qe krahas prodhuesve ofertues ne procedure te jene edhe OE qe ofrojne produkte te prodhuesve te tjere, synon nxitjen e konkureses dhe rritjen e pjesmarrjes ne procedure por me ane te autorizimit te prodhuesit Ak synon te krijojë bindjen ne angazhimin dhe mundesite reale te ofertuesit per realizimin me sukses te kontrates.

3. OE ofertes në këtë procedure prokurimi duhet te vertetojne se e zhvillojne aktivitetin e tyre tregtar ne fushen objekt prokurimi me standartet nderkombtare ISO ,te menaxhimit te cilsise, te shendetit dhe sigurise ne pune dhe te mjedisit. Per kete duhet te paraqesin certifikatat e meposhtme:

ISO 9001:2015, Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë .

ISO 45001:2018 .Per Sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne punë.

ISO 14001 :2015 Per Sistemet e menaxhimit të mjedisit.

Certifikatat e mesiperme duhet te paraqiten origjinale ose kopje te noterizuara,te leshuara nga nje organ I vlersimit te konformitetit , I akredituar nga organizata kombetare e akreditimit ose organizma nderkombtar akreditues,te njohura nga Republika e Shqiperisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kërkesa per certifikaten ISO 9001 :2015 synon te garantoje AK se OE ofertues aplikojne nje system te menaxhimit te cilesise,I cili demonstron aftesine e tij per te siguruar vazhdimisht produkte dhe sherbime qe plotesojne kerkesat e klientit dhe angazhohen ne procese qe synojne permirsimin dhe pershtatjen me kerkesat e cilesise se klientit.Kerkesa e standartit Iso 9001 jane te pergjithshme dhe kane per qellim te jene te zbatueshme per cdo organizate,pavarsisht nga lloji ose nga madhesia e saj,ose produktet dhe sherbimet qe ofron.

Kerkesa per certifikaten ISO 45001:2018 synon te garantoje Ak ose OE ofertues aplikojn standartet e kerkuara ne vlersimin e rreziqeve te aksidenteve ne pune,vendosjen e masave ne fushen e shendetit dhe sigurise,inkurajimin e pjesmarrjes se punojseve ne perpjekje per te permirsuar kushtet e punes,zbatimin e masave per te zvogeluar rreziqet e aksidenteve dhe semundjeve si dhe hetimin e incidenteve.Certifikimi ISO 45001 mund te meret nga cdo kompani,pamvarsisht aktivitetit te saj si dhe rrisqeve te shendetit dhe sigurise.Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqerise per te mare masat e nevojshme per te mbrojtur punojset e saj dhe cdo personi tjeter ne mabjentet e saj.

Kerkesa per certifikaten ISO 14001:2015 synon të garantoje AK se OE ofertues zbatojne masa ne funksion te permirsimit te performances mjedisore nepermjet uljes se sasise te mbetjeve te gjeneruara dhe perdorimin me efikasitet te burimeve natyrore,me qellim uljen ose eliminimin e efekteve negative mbi mjedisin te lidhura me aktivitetet e shoqerise.

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës, në funksion të përmbushjes me sukses të kontrates duhet te vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar, si më poshtë :

Te pakten një Inxhinier tekstil

Të pakten një Stilist / modelist

Per sa me sipër operatorët ekonomike duhet të paraqesin : Kontrate pune, diplomë universitare për inxhinierin tekstil , te lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) telicencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore,kontrate pune,CV .

Për punonjësin Silist/Modelist Kontratë pune,CV, dokument që të vertetojnë kualifikimin profesional ( dëshmi kualifikimi profesional/certifikate), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) te licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh. Personeli i kualifikuar duhet të jetë pjesë e pervojës së ofertuesit dhe per këtë OE duhet të deshmojnë se kanë patur në listpagesat e shogörisë per periudhën Korrik - Dhjetor 2022 punonjësit e deklaruar.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomike te formularit permbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni proves do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77/4 te Ligjit nr. 162, date23.12.2020 "Per Prokurimin Publik" dhe nenin 40/5 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".Ky kriter eshte i nevojshem pasi OE pjesmarres provojnë besueshmerine dhe pervojen e tyre ne realizimin e kontrates pa vonesa dhe pengesa, qe do të ndikonin ne ecurine e punës se AK. Personeli i kualifikuar (inxhinier tekstili dhe stilist/modelist) është kerkuar referuar parashikimeve te VKM nr. 514, date 20.09.2017 "Per miratimin e listës kombëtare te profesioneve te rishikuar (LKP)" dhe konkretisht realizon proceset e punës si vijon:

Kodi i profesionit: 7532,përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve "Modelistë, prestarë dhe punonjës të tjerë të ngjashëm", niveli i dytë i kompetencës në LKP. Modelisti, prestari dhe punonjës të tjerë të ngjashëm, krijon modele pune të perpikta per prodhimin e rrobave dhe tekstileve . Ai vijëzon, pret, jep form dhe stolis tekstile, në bazë të specifikimeve për prodhimin e veshjeve, kapelave, dorashkave dhe produkteve t ëtjera të ndryshme. Prerësi I modeleve kryen rolin e një ndermjetësi midis stilistit dhe punuesit apo prodhuesit të tekstileve.

Inxhinieri I Tekstilit eshte nje inxhinier qe ne fushen e tij perdor parimet shkencore dhe inxhinierike per te prodhuar produkte tekstili sic jane veshjet.

Nje inxhinier tekstili eshte nje profesionist qe kerkon edhe studion materialet e tekstilit, duke perfshire fibrat, fijet edhe pelhurat, dizajnon produkte cilesore edhe percakton teknike te reja prodhimi. Keshtu nje inxhinier tekstili mund te zhvilloje pelhura zjarrduruese per uniformat e ose te krijojte materiale biomedikale per organe artificiale. Inxhinieri I Tekstilit mundte punoje ne disa fusha qe nga fabrikimi I pelhurave edhe aksesoreve,duke perfshire kerkim edhe zhvillim,prodhim veshjesh ne te gjitha proceset ,kontroll te cilesise edhe menaxhim profesional . Inxhinieri I Tekstilit mund te percaktoje materialet e paperpunuara qe duhen perdorur per te krijuar veshjet e duhura Gjithashtu gjate proceseve te prodhimit mund te observeje edhe koordinoje me tekniket per te identifikuar menyra qe i bejne operacionet me eficente. Nje inxhinier tekstili mund te implementoje edhe mbikqyr proceset e kontrollite cilesise per te siguruar perputhshmerine e produktit me standartet e cilesise edhe konformitetin e tyre ne specifikimet teknike te kerkuara.

Modelisti ose stilisti,puna e tyre perfshin kryesisht keshillime edhe konsulenca profesionale per klientet e tyre, duke perzgjedhur edhe koordinuar pamjet e dizenuara ose foto me proceset e metejshme.

Nje modelist duhet te perzgjedhe edhe pershtase per prodhim modelet.

Modelisti eshte pergjegjes per koordinimin e cdo detaji dekorativ edhe funksional ndermjet porositesit edhe prodhuesit duke organizuar edhe shpjeguar materialet edhe aksesoret e duhur per realizimin ne perputhje me standartet e cilësisë.

Ata jane personat pergjegjes per porositjen e veshjeve,materialeve bazeedhe ndihmese duke ndihmuar keshtu ne zhvillimin edhe krijimin e nje stili edhe dizajni terheqes. Stilistet/Modelistet jane

gjithashtu pergjegjes per Adaptimin e interesave te porositesit. Ata jane Konsulente edhe punojne shume afer me expertet edhe profesionistet e tjere te sektorit kudo ku lind nevoja. Ata konsultojne edhe keshillojne prodhuesin per cdo detaj teknik per realizimin e modeleve te kerkuara. Jane personat pergjegjes per marrjen e masave trupore te klientit edhe pershtatjen profesionale me urdherin e porosise tek Prodhuesi.

5.OE duhet të paraqesin certifikatë OEKO-TEX ose ekuivalent, për produktet (të lëshuar në emër të tij ose të prodhuesit).

**Agrumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është i nevojshëm që OE për të gjithë artikujt e kërkuar te tekstilit të jenë të përshtatshëm dhe me certifikim standart, duke filluar nga fijet në pëlkurat e përfunduara dhe artikujt e përfunduar. Kjo përfshin fijet, butonat, zinxhirët dhe veshjet. Çdo artikull tekstili të mbajë etiketën standart, të jenë të sigurt dhe testuar për substanca të dëmshme si dhe artikulli është i padëmshëm në aspektin ekologjik njerezor, pa substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut. Oeko tex certificate është një certifikim për produktet e tekstilit edhe lekures që verifikon sigurinë e tyre kimike. oeko tex është kodi i shoqates ndërkombetare për kërkim edhe testim në fushën e tekstileve edhe lekures. Ky lloj certifikimi teston artikujt për një sërë kimikatesh edhe certifikon ato nëse janë të sigurta për përdorim. Kur një produkt ka CERTIFIKIM OEKO TEX do të thote që cdo komponent I produktit-duke përfshirë kopsat, butonat, astaret ,frazelinat,penjte, zinxhoret, zbukurimet, aksesoret janë testuar kundrejt një liste të gjatë të substancave të dëmshme edhe janë gjetur të sigurta për shëndetin njerezor. për këtë arsye kërkohet që produktet në teresi jo vetëm lenda e pare të jene të certifikuara me oeko tex.

6. OE ofertues përveç se duhet të paraqesin dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (Raporte testimi ose çdo dokument tjetër të barasvlefshëm) të materialeve përbërëse të produkteve, për të gjithë artikujt objekt prokurimi, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose Laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me Specifikimet teknike të kërkuara. OE ofertues duhet gjithashtu të paraqesin nga 1 (një) model (mostër) të prodhuar për këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të Specifikimeve teknike të kërkuara, për secilin nga artikujt objekt prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor me adresë: Rr.Ibrahim Rugova „Ish Garda e Republikës”, Tiranë. në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër "emri i artikullit", datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ ofertuesit.

- a) Mostrat fizike të ndërtuara me lëndë të parë tekstil të jenë të shoqëruara me nga një pjesë 0,3- 0,5 ml gjatësi lëndë të parë (tekstil sipas objekteve të uniformës) dhe sa gjerësia e vetë tekstilit në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit. Të dyja anët e tekstilit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt) dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike të tyre. (Loti 2)
- b) Mostrat fizike si këpucet etj të ndërtuar me lëndë të parë lëkure të jenë shoqëruar nga një pjesë 0,3X0,3cm lëkure në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit dhe

të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike te tyre. (Loti 1)

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e e procedurave.

**Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 40/6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". OE, duhet të vërtetojnë se mallrat objekt prokurimi, uniformat, janë në përputhje me kërkesat minimale, parametrat teknike të dhëna tek specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në DT. Gjithashtu kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 40/6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Paraqitja e këtyre mostrave do i shërbejë Komisionit të Vleresimit të Ofertave (KVO) të AK, për të verifikuar edhe vizualisht nëse mallrat e ofertuar i plotesojnë specifikimet teknike të përcaktuara në DT, të tilla si p.sh. ngjyra e artikujve, duke krahasuar përputhshmerine e tyre me uniformat aktuale të AK.

7. OE për secilin nga artikujt e uniformës, referuar specifikimeve teknike duhet të paraqesin çertifikatë të lëshuara sipas rregullores së miratuar të Bashkimit Evropian me anë të së cilës vërtetohet se artikujt janë modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me Rregulloren EU nr.425/2016 sipas specifikimeve teknike, në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN. Qellimi i kesaj rregullore eshte te siguroje standarte te perbashketa per pajisjet mbrojtese personale ne drejtim te mbrojtjes se dhendetit dhe sigurise se perdoruesve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo kërkesë siguron AK se mallrat e kërkuar përmbushin kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas dispozitës së mësipërme të komunitetit evropian.

8. OE duhet të lëshojnë një Deklaratë se artikujt objekt prokurimi do të kenë një afat garancie prej 1 (një) viti nga data e furnizimit të tyre, si dhe të garantohet AK se këta artikuj gjatë periudhës së garancisë nuk do të ndryshojnë karakteristikat e ngjyrës/ cilësisë sipas Specifikimeve teknike, në të kundërt OE detyrohet ti zëvendësojë ato me artikuj të rinj.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo kërkesë/ dokument është i nevojshëm që OE për të gjithë artikujt e kërkuar të uniformave, të jenë në përputhje me parametrat teknike të dhëna tek specifikimeve teknike dhe me standartet e kërkuara në DT, duke u bazuar në specifikat e punës që kryejnë, personeli që do të perdore, kushtet e punës, imazhi i AK, siguria në cilësi.

9. OE duhet të dorëzojnë një Deklaratë ku të marrë përsipër dorëzimin e mallrave/ artikujve objekt prokurimi/ kontrate pranë magazinës së AK në Tiranë, ku ndodhet selia qendrore e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo kërkesë, dokument është i nevojshëm për AK, që OE për të gjithë artikujt e kërkuar

te uniformave, ti përgjigjet në kohë AK, duke mos u penguar kjo e fundit në ushtrimin e aktivitetit të saj, bazuar në rendësinë e objekteve në të cilat AK realizon detyrat funksionale. Ky kriter është i nevojshëm që OE pjesëmarrës të provojnë besueshmerine dhe dakortesine e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikonte në performancen, imazhin/ ecurine e punës së AK.